

VENDIM
Nr.581, datë 16.5.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË AUTOKOLONE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokoloNë ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa të armatosura, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 18 maj 2008, dhe lejimin e kalimit transit të po kësaj autokoloNë në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 24 maj 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 18 maj 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 24 maj 2008, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolona ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha